



SHPLLJE VETEM PËR NËPUNËS CIVILË, LËVIZJE PARALELE DHE PËR NGRITJEN NË DETYRË

Drejt看 i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Instituti i Statistikave

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Instituti i Statistikave shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

Drejt看 i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Instituti i Statistikave – kategoria II-2

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë)
aplikohet në të njëjtën kohë!**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për
LEVIZJE PARALELE:**

26 Qershor 2025

**Afati për dorëzimin e dokumentave për
NGRITJE NE DETYRE:**

01 Korrik 2025

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore raporton tek Sekretari i Përgjithshëm dhe ka përgjegjësi të plotë për menaxhimin strategjik dhe operacional të funksioneve të burimeve njerëzore. Ai/ajo udhëheq dhe mbikëqyr të gjitha proceset që lidhen me menaxhimin e ciklit të plotë të punonjësve, duke përfshirë: rekrutimin, trajnimin, zhvillimin profesional, vlerësimin e performancës si dhe motivimin e stafit. Disa nga përgjegjësitë kryesore janë:

- a. Menaxhimi i politikave dhe procedurave për rekrutimin, trajnimin, zhvillimin dhe vlerësimin e punonjësve.
- b. Sigurimi i pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret lidhur me burimet njerëzore dhe trajtimin e punonjësve.
- c. Hartimi i strategjive, implementimi i programeve të trajnimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm të stafit.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civilë të konfirmuar, brenda kategorisë së mesme drejtuese;
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" apo " Master Profesional" të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Shkenca Ekonomike/Shoqërore. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion;
- c- Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë bashkë me kërkesën duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i përditësuar, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike, adresën postare, kodin e shpalljes publike dhe emërtesën e plotë të pozicionit të punës;

- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor); Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore në fuqi.
- i- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në INSTAT brenda **datës 26 Qershor 2025**.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **30 Qershor 2025**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Institutin e Statistikave, *(nëpërmjet adresës së e-mail)*, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Ligji nr 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” (http://www.instat.gov.al/media/3973/ligj-nr-17-dt-542018_per-statistikat-zyrtare.pdf);
2. Ligji nr.152/2013, “Për Nëpunësit Civil” ([Për Shërbimin Civil \(dap.gov.al\)](http://www.dap.gov.al)) dhe të gjitha aktet ligjore në zbatim të tij;
3. Ligji nr. 7961, datë 12.07.1991 “Kodi i Punës në R.SH.” i ndryshuar
4. Ligji nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (<https://www.ildkpkj.al/legjislacioni-3/>)
5. Vkm nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”; (<https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-sherbimin-civil>)
6. Ligji nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” (<https://www.kryeministria.al/wp-content/uploads/2021/10/ligj-2003-09-08-9131.pdf>)

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi fushën e njohurive, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.
- Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”.

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në INSTAT do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të INSTAT, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2 NGRITJA NË DETYRË

*Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrim nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Institutit të Statistikave, duke filluar nga data **11 Korrik 2025**.*

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë së ulët drejtuese;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" apo " Master Profesional" të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike në Shkenca Ekonomike/Shoqërore. Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion;
- c- Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i përditësuar, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike, adresën postare, kodin e shpalljes publike dhe emërtesën e plotë të pozicionit të punës;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor); Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Institutin e Statistikave brënda datës 01 Korrik 2025.

Duke filluar nga data **11 Korrik 2025**, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Institutin e Statistikave do të shpallë në faqen e internetit të institucionit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në INSTAT, për shkaqet e moskualifikimit (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi fushën e njohurive, aftësitë, kompetencat në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Institutit të Statistikave do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*). Drejtoria e Burimeve Njerëzore në INSTAT do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në faqen e Institutit të Statistikave, për fazat e mëtejshme të kesaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Institutit të Statistikave duke filluar nga data **11 Korrik 2025**.